



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL

SEKTORI I ARSIMIT KULTURËS DHE SPORTEVE

Nr. 3256 Prot.

Urë Vajgurore më, 15/11/2024

Lënda: Relacion për “Miratimin e krijimit të Këshillit Artistiko-kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”

KËSHILLIT BASHKIAK DIMAL

I Nderuar Z. Kryetar i Këshillit Bashkiak / Të Nderuar Zonja dhe Zotërinj këshilltarë të Këshillit Bashkiak Dimal !

Sektori i Arsimit, Kulturës dhe Sporteve, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1/1.1 shkronja d, nenit 25 pika 2 dhe 4, nenit 55, pika 2 dhe 6, nenit 64 pika j, të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë; VKM nr. 540, datë 21.12.1992 “Për krijimin e Këshillave Artistiko-Kulturorë dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre”, i ndryshuar; Udhëzimit të ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve” nr. 1 dt. 24.05.2005 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të të Këshillave Artistiko-kulturorë; ligjit nr. 10352, dt. 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën” i ndryshuar; Rregullores për financimin e shpenzimeve operative dhe kapitale të buxhetit të Bashkisë Dimal; ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; VKM 1173, dt. 06/11/2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura” për procedurën që do të ndiqet për realizimin e këtij programi; VKB nr.52 datë 26.12.2023 “Për miratimin e programit Buxhetor Afat Mesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Dimal për vitin 2024”;

JU vë në dijeni se për sa më sipër del e nevojshme nga Këshilli Bashkiak Dimal:

1. Të miratojë përbërjen e Këshillit Artistiko-Kulturor për periudhën 2024-2026.
2. Pagesa për çdo anëtar të Këshillit Artistiko – Kulturor është 4500 (katër mijë e pesëqind) lekë për çdo mbledhje.

Nisur nga rritja e fluksit të kërkesave të banorëve të zones sonë si dhe nga mungesa e aktiviteteve të tjera private në vend, për sa i përket artit dhe kulturës, në nivel bashkie, paraqitet domosdoshmëria për krijimin e Këshillit Artistiko – kulturor, i cili me metoda të ndryshme inovative dhe promovuese do të ndërmarrë nismën që nëpërmjet aktiviteteve përkatëse të shtojë ngjyrimet e ndryshme kulturore artistike dhe sportive për zhvillimin e këtij spektri në vendin tonë.

Kultura është identiteti ynë, arti është jeta jonë dhe rinia e ardhmja e këtij vendi. Të ndërthurura së bashku kërkojnë realizimin e projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme duke

kontribuar në mirëqënien dhe zhvillimin e vendit. Ky grup artistik do të funksionojë si syri dhe veshi artistik i qytetit tonë duke ardhur mes nesh here pas here për të organizuar evente me vlera artistike, kulturore me impakt të gjerë në shoqëri.

Nga eksperiencia e viteve të shkuara, Këshilli ka qenë gjithmonë pranë me Grupin Polifonik "Osumi", Skuadrën tonë të Futbollit "Osumi", me aktivitete të tjera kulturore si takimi i hapur në Kalanë e Dimalit, apo aktivitete të tjera kombëtare apo vendase.

Synimi kryesor i këtij Këshilli është rivitalizimi i jetës artistike në vend, duke promovuar ato vlera që mbart vendi ynë, e duke zhvilluar më tej vlerat historike monumentale.

Këshilli Artiatiko-Kulturor do të ushtrojë funksionin dhe veprimtarinë e tij për një afat 2-vjeçar.

Përsa më sipër, lind nevoja t' i drejtohem Këshillit Bashkiak Dimal, që të japë pëlqimin dhe miratimin për krijimin e "Këshillit Artistiko-kulturor" me përbërje si më poshtë:


- ✓ Albano Kora
- ✓ Besjana Hoxha
- ✓ Mateo Plaku
- ✓ Kozma Dushi
- ✓ Adrian Hodaj
- ✓ Trifon Qyli

Për këtë arsye dhe për sa u shprehëm edhe më sipër, Ju drejtohem Ju të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak që jepni aprovimin dhe miratimin tuaj si Këshill Bashkiak, për të vazhduar më tej, procedurat e krijimit të tij.

Në bashkëpunimin Tuaj!

Për zyrën e Arsimit, Kulturës & Sporteve:

Besjana Hoxha


**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
RAJMONDA SHUKA**

**KRYETAR
JULIANA MEMAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
SEKTORI I ARSIMIT KULTURËS DHE SPORTEVE

Nr. 3256/ Prot.

Urë Vajgurore më, 15/11/2024

PROJEKT VENDIM

Nr. ____, Dt. __/__/2024

“MBI MIRATIMI E KËSHILLIT ARTISTIKO KULTUROR DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË TIJ”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1/1.1 shkronja d, nenit 25 pika 2 dhe 4, nenit 55, pika 2 dhe 6, nenit 64 pika j, të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë; VKM nr. 540, datë 21.12.1992 “Për krijimin e Këshillave Artistiko-Kulturore dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre”, i ndryshuar; Udhëzimit të ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve” nr. 1 dt. 24.05.2005 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të të Këshillave Artistikokulturore; ligjit nr. 10352, dt. 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën” i ndryshuar; Rregullores për financimin e shpenzimeve operative dhe kapitale të buxhetit të Bashkisë Dimal; ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; VKM 1173, dt. 06/11/2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura” për procedurën që do të ndiqet për realizimin e këtij programi; VKB nr.52 datë 26.12.2023 “Për miratimin e programit Buxhetor Afat Mesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Dimal për vitin 2024”;

PROPOZON

ME ____ VOTA PRO NGA ____ KËSHILLTARË PREZENTË

1. Të miratojë përbërjen e Këshillit Artistiko-Kulturore për periudhën 2024-2026 me përbërje si më poshtë:
 - ✓ Albano Kora
 - ✓ Besjana Hoxha
 - ✓ Mateo Plaku
 - ✓ Kozma Dushi
 - ✓ Adrian Hodaj
 - ✓ Trifon Qyli
2. Pagesa për çdo anëtar të Këshillit Artistiko – Kulturore është 4500 (katër mijë e pesëqind) lekë për çdo mbledhje.
3. Këshilli Artistiko-Kulturore i krijuar, do të ushtrojë funksionin e tij për një afat 2-vjeçar.

4. Komisioni do të mbledhet jo më shumë se 6 mbledhje në vit për aktivitete të ndryshme.
5. Ngarkohet për zbatim të këtij vendimi Sektori i Arsimit, Kulturës & Sporteve, Sektori Juridik dhe Drejtoria e Financës.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij, sipas parashikimeve të Nenit 55, pika 6 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Për zyrën e Arsimit, Kulturës & Sporteve

Besjana Hoxha

Albana Hoxha

Sekretar i Këshillit

Arta Hoxha

Arta

Konfirmoi bazën ligjore

Sp. Jurist: Mateo Plaku

KRYETAR

Juliana Memaj

*Ne mungon dhe ne uletet
Sekretar i Regjistrimit
Rajmondo Stulq*